

V E N D I M

“PËR SEKUESTRIMIN E PASURISË”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda e përbërë nga:

GURALI BRAHIMLLARI - KRYESUES

Asistuar nga sekretare gjyqësore **Suela Arapi** në disa seanca gjyqësore publike, seanca e fundit sot, në date 15.01.2010, ora 13.00, mori në shqyrtim, kërkesën që ju përket palëve:

Kërkues: Prokuroria prane Gjykatës Për Krime të Rënda,
përfaqësuar nga **Adnan Xholi dhe Besnik Muçi.**

Kundër: Të pandehurit, (I dyshuar) N.C, i lindur në Ersekë dhe banues në Tiranë.

Persona të Tretë, (gjini e afërt me të dyshuarin N.C)

- V.C, lindur dhe banues në Tiranë, me arsim te mesem.
- I.C lindur ne XXX Kolonje dhe banues në Tiranë.
- SH.C lindur në Përmet e banuese ne Tirane.

Persona të Tretë(sipas nenit 16 të ligjit 9284):

- L.F lindur në Durrës dhe banues neTirane
- A.F lindur ne Librazhd dhe banues ne Tirane.

Objekti: I.Sekuestrimin paraprak të pasurive të mëposhtme:

1.Mjetin tip Nissan, me tagra XXXX, në pronësi të pandehurit N.C.

2. Mjetin me targa XXXX, në pronësi të personit te trete V.C

3.Vleta monetare te sekuestruara ne Agjensine “XXX” Tirane.

Shuma 598.200 leke.Shuma prej 2700 Euro. Shuma prej 40 USD. Shuma prej 60 Paund. Shuma prej 200 Dhrami

4. Shumen prej 1970 USD e depozituar prej personit të tretë V.C, ne banken amerikane te Shqiperise.

5.Shumën 1 036 095 leke depozituar nga personi i Tretë I.C në Raiffeisen Bank në llogarinë nr.xxxxxxxxxx.

6. Apartament në pronesi të të dyshuarit N.C ndodhur ne rrugën XXX, zona kadastrale nr. xxxx, rregjistri xxx, nr. rendor xxx, Tirane.

7.Apartament në rrugen XXX nr. 7/3 kati i shtate ne pronësi të personit te trete SH.C, zona kadastrale xxxx.

8. Apartament ne pronesi te te dyshuarit N.C ndodhur ne rrugen XXX pall.2 Shkalla 9, Ap.97 i blere me kontraten e dates 17.02.2000 dhe i rregjistruar ne Zyren e Rregjistrimit te pasurive.

II. Sekuestrimin e pasurive te siperpershkruara.

III.Per sekuestrimin paraprak, sekuestrimin dhe perdorimin e ketyre pasurive te ngarkohet Agjensia per Administrimin e Pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara prane Ministrise se Finances Tirane.

Baza ligjore: Ligji 9284 dt. 30.09.2004 “Per parandalimin dhe goditjen kunder krimet te organizuar”

Në përfundim të gjykimit palët kërkuar:

1.Përfaqësuesi i Orgnit të Prokurorisë, prokurori Besnik Muçi kërkoj:

1- Sekuestrimin e pasurive të mëposhtme:

- **Mjetit** tip Nissan me targa TR xxxx X në pronësi të të pandehurit N.C, ndodhur në Komisariatit e Policisë nr. 4

- **Mjetit** me targa XXXX në pronësi të shtetases V.C, bashkëshortja e të pandehurit N.C, ndodhur në Komisariatit e Policisë nr. X

- **Vlerave monetare** të sekuestruara në Agjensinë “Go Uest” Tiranë:

- Shuma 598 200 Lekë

- Shuma prej 2700 Euro

- Shuma prej 40 USD

- Shuma prej 60 Paund

- Shuma prej 200 Dhrahmi.

- **Shumës prej 1970 USD** e depozituar prej shtetases V.C, bashkëshortja e të pandehurit N.C, në bankën Amerikane të Shqipërisë

- **Shumës prej 1 036 095** lekë depozituar nga shtetasi **I.C**, babai i të pandehurit N.C, në Raiffeisen Bank në Ilgarinë nr. XXXXXXXX

- **Apartamentit** në pronësi të të pandehurit **N.C** ndodhur në rrugën XXXX 130 m2 zona kadastrale nr. XXX, regjistri XXX nr. Rendor XXX Tiranë, së bashku me paisjet që ndodhen brenda në apartament.

- **Apartamentit** në rrugën XXX, nr. 7/3, kati i shtatë, në pronësi të shtetases **SH.C**, nëna e të pandehurit N.C, zona kadastrale XXXX së bashku me paisjet që ndodhen brenda në apartament.

- **Apartamentit** në pronësi të të pandehurit **N.C** ndodhur në rrugën XXX pall. 2 shkalla 9 ap 97, I blerë me kontratën e datës 17.02.2000 dhe i paregjistruar në Zyrën e Regjistrimit të pasurive së bashku me paisjet që ndodhen brenda në apartament.

2. Për sekuestrimin, ekzekutimin e vendimeve të gjykatës dhe administrimin e këtyre pasurive të ngarkohet menjëherë **z.E.B**, administrator i Agjensise për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave - Tiranë.

Mbrojtësi B.R kerkoi: Rrëzimin e kërkesës së prokurorit objekt shqyrtimi në këtë gjykim lidhur me sekuestrot e kërkuara për pasuritë e tundëshme dhe të patundëshme të N dhe V.C dhe prindërve të tij I dhe SH.C, si një kërkesë që nuk bazohet as në ligj dhe as në prova dhe që bie ndesh me praktikën Unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

I pandehuri N.C dakortë me mbrojtësin.

Gjykata, pasi shqyrtoi aktet e provat shkresore dhe ato me dëshmita paraqitur në seancë gjyqësore nga palët në gjykim, si dhe i analizoi e vlerësoi ato

V E R E N s e

Gjykimi i kësaj kërkesë u bë në kushtet kur Gjykata e Apelit për Krime të Rënda me Vendim nr 09 datë 09.06.2009 ka vendosur:

“Prishjen e Vendimit nr 03 datë 17.04.2009 të Gjykatës së Shkallës së parë për Krime të Rënda dhe dërgimin e çështjes për rigjykim, në po

atë gjykatë , më tjetër trup gjykues, për shakun se nuk ishte formuar drejt ndërgjysësia.

Mbi bazën e akteve të fashikullit rezulton se objekti gjykimit është edhe një pasuri e paluajtëshme e llojit “Apartament” I ndodhur në rrugën XXXX, pall. 2 shkalla 9 ap 97, Tiranë, e cila ndonëse është blerë nga I pandehuri N.C, është e rregjistruar ne Zyrën e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme Tiranë në emër të shitësit L.F.

Në bazë të orinetimeve të dhëna në Vendimin e sipërcituar të Gjykatës së Apelit, me të cilin çështja u kthye për rigjykim, u thirr me cilësinë e personit te trete ne kete gjykim edhe shtetasi L.F. Madje Gjykata thirri me këtë cilësi të dy bashkëshortët L.F dhe A.F sepse në kontratën e shitjes ka nënshkruar edhe bashkëshortja e tij A.F dhe se gjykata vlerësoi se edhe ajo ka të njëjtat interesa si dhe bashkëshorti i saj L për këtë pasuri.

Për njoftimin e personave të Trete L e A.F, u krye procedura e paraparë në Kodin e Procedurës Civile, u bënë verifikime të plota për vendbanimin e tyre, por ata nuk u gjëndën dhe gjykata erdhi në dijeni se janë larguar jashtë shtetit, në ShBA, por pa adresë të përcaktuar. (Këtë fakt e deklaroi më pas, në seancë gjyqësore edhe dëshmitarja **RR.P** nëna e personit të Trete A.F.)

Meqënëse nuk u gjëndën, njoftimi i Personave të Tretë, L.F dhe A.F, u bë në përputhje me parashikimin e nenit 133 të K.Pr.Civile, me shpallje në Zyrën e Gjëndjes Civile ku ndodhen aktualisht të rregjistruar si banorë.

Nga aktet rezulton e provuar se ata jane ende banorë të Njësisë Bashkiake Nr.09 Tiranë, prandaj shpallja u vendos ne mjediset e Gjendjes Civile të kësaj Njësie si dhe ne mjediset e Gjykates se Shkallës së Parë për Krime të Rënda, që janë për njoftimet për publikun.

Personat e Trete L.F dhe A.F nuk u paraqitën në seancë gjyqësore dhe gjykimi u zhvillua në mungesë të tyre.

I pandehuri N.C mori pjesë personalisht gjatë gjithë gjykimet dhe u përfaqësua në gjykim nga avokati B.R, I cili ishte njekohësisht edhe mbrojtës i Personave të Tretë, V, I dhe SH.C, gjini e afërt e të dyshuarit, respektivisht bashkëshorte dhe prindërit e N.C.

Lidhur me themelin e kërkesës për sekuestrimin e pasurive objekt gjykimi, Gjykata konstaton se nga aktet e provat e paraqitura nga palet ne gjykim rezulton se Prokuroria për Krime të Rënda **ka rregjistruar**

procedimin penal Nr. 72 datë regjistrimi 01.08.2005 në ngarkim të të pandehurve **N.C, E.B, V.T, E.C, P.K, A.F, V.C, S.M dhe A.L** të akuzuar per veprat penale të « Grupi i strukturuar kriminal », « Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grup i strukturuar kriminal », « Falsifikimit te dokumentave », « Falsifikimit te leternjoftimit, pasaportave apo vizave », « Falsifikimit te vulave, stampave ose formulareve », « Prodhimit dhe mbajtja pa leje e armeve luftarake dhe e municionit », « Prodhimit te mjeteve per falsifikimin e dokumentave », « Ndhurma per kalim te paligjshem te kufirit », parashikuar respektivisht si krime nga nenet 186 parg.2, 189 parg.2, 190 parg.2, 192, 278/2, 298 parg.3, **333/a parg. 2 dhe 334/1 i Kodit Penal.**

Sipas Prokurorit janë zhvilluar hetimet paraprake prej të cilave ka rezultuar se i pandehuri N.C ka qene pronar i agjensisë se udhetimeve “xx xxxx” me vendodhje tek XXXX, Tirane dhe se ne bashkepunim me te pandehurit e tjere organizonte kalimin e paligjshem te kufirit, te shtetasve te ndryshem, duke i pajisur me viza, dokumenta te fallsifikuara kundrejt pageses ne varesi te linjave te udhetimit qe variojne ne shumat 10.500 deri ne 16.000 euro.

Sipas akteve krijohet dyshimi I arsyeshëm I mbështetur në prova se I dyshuari N këtë veprimtari kriminale e ka kyer në bashkëpunim me të pandehurit e tjerë. Te pandehurit **E.B, S.M** merrnin kerkesat nga persona te ndryshem per te shkuar jashte shteti, kerkonin prej tyre dokumentat e nevojshme, vendosin cmimet ne vartesi te shtetit te destinacionit dhe me pas bisedonin me te i pandehuri N.C, i cili mundesonte gjetjen ose pershtatjen e dokumentave te fallsifikuara, vinte ne dispozicion biletat e udhetimit, percaktonte itinerarin e levizjes dhe mbante lidhje me bashkepunetore te tjere ne shtetin, ku ishte destinacioni i dergimit.

I pandehuri N.C, kerkonte nga personat qe do te niseshin jashte shteti pasaporten dhe 2 fotografi ose certifikate me fotografi, me te cilat me pas realizonte vizen e fallsifikuar ne pasaporte ose fallsifikonte nje pasaporte te huaj ne emer te shtetasit qe do te kalonte kufirin per jashte shteti. Veprimtari te cilin i pandehuri N.C e realizonte ne ambientet e **apartamentit ne emer te SH.C, ne rrugen “XXXXX”, te pershtatur si “Laborator”** per fallsifikimet.

Sipas prokurorit, i pandehuri N.C dhe bashkepunetori i tij E.B, ndiqnin disa linja te kontrabandimit te njerezve per jashte shteti dhe me kryesoret prej tyre ishin: nepermjet Pikes se Kalimit Kufitar Kapshtice dhe linja tjeter nepermjet Pikes se Kalimit Kufitar Rinas.

Nëpërmjet **Pikes se kalimit Kufitar të Rinasit, gjithnje në rrugë ajrore**, klandestinet shkonin ne Itali nga ku niseshin me tren per ne vende e te ndryshme te Europes madje edhe ne SHBA. Ne disa raste te tjera NC i niste klandestinet nga qyteti i Stambollit, Turqi drejt Antalias, nga ku me pas klandestinet drejtohen ne vende te ndryshme te BE-se sipas vendit te destinacionit.

Klandestinet paguanin nje pjese te parave të pandehurve N.C e E.B, kurse pjesa tjeter dorezohej nga familjaret ne momentin e mberritjes ne destinacion. Kalimi i klandestineve favorizohej nga personat nen hetim me ish-detyre shteterore ne kete aeroport nga i pandehuri **E.C A.F** dhe **B.S.**

Mbi bazën e fakteve të mësipërme, në këtë gjykim u provua se ndaj të pandehurve të sipërcituar në fazën e hetimeve paraprake, janë dhënë Vendimet Gjyqësore per caktimin e masave te sigurimit personal sipas të cilave ekziston dyshimi i arsyeshëm i mbështetur në prova se të pandehurit e sipërcituar janë përfshirë në veprimtarinë kriminale per te cilen jane akuzuar dhe se niveli i bashkëpunimit mes disa prej tyre, ku përfshihet edhe I dyshuari N.C, ka qënë në formën e “grupit të strukturuar criminal” sic parashikon neni 28 I K.Penal.

Edhe ndaj te pandehurit N.C, është dhënë Vendimi Nr.160 datë 09.10.2005 me te cilin eshte vleftesuar i ligjshem ndalimi i tij dhe është caktuar masa e sigurimit “Arrest ne burg” sipas nenit 238 të K.Pr.Penale.

Gjithashtu ndaj këtij të pandehuri është dhënë dhe vendimi me nr. 96 dt. 21.04.2006 për caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”.

Ndërsa më pas, procedimi penal është dërguar për gjykim në Gjykatën e Krimeve të Rënda Tiranë e cila me Vendimin nr. 50 datë 29.07.2008 ka vendosur, midis të tjerëve, dhe deklarimin fajtor dhe dënimin e të pandehurve **N.C, E.B dhe E.C si dhe për të pandehurit e tjerë**, për kryerjen e veprave penale të mësipërme te kryera në bashkëpunim, dhe tre te pandehurit e mësipërm, bashkëpunimi në kryerjen e veprave penale ka qënë në nivelin e « Grupit të strukturuar

kriminal » në përputhje me akuzat e ngritura në fazën e hetimeve paraprake.

Perfundimisht, ne baze te nenit 55 te Kodit Penal, nga gjykata e Shkallës së Parë, I pandehuri N.I.C është dënuar me 11 (njembedhjetë) vjet burgim dhe 8.000.000 (tete milione) leke gjobe.

Edhe për të pandehurit e tjere gjykata ka konkluduar në fajësinë e tyre dhe respektivisht i pandehuri E.B është dënuar përfundimisht me 11 (njembedhjetë) vjet burgim dhe 8.000.000 (tete milione) leke gjobe, dhe E.C është dënuar përfundimisht me 10 (dhjetë) vjet burgim dhe 8.000.000 (tetemilione) leke gjobe.

Gjykata e shkallës së parë me vendimin e sipërcituar ka disponuar edhe për provat material dhe disa sende e pasuri te sekuestruara duke urdheruar konfiskimin ose kthimin e tyre.

Mes këtyre pasurive, në gjykimn penal është shqytuar kërkesa e Prokurorit dhe është disponur në Vendimin e sipercituar penal edhe për pasuritë objekt i këtij gjykimi parandalues dhe konkretisht për apartamentin ne rrugën XXXXX që është i rregjistruar në emër të Personit të Tretë SH.C si dhe për vlerat monetare të gjendura e sekuestruara në mjediset e shoqërise “XXX”.

Gjykate e Apelit per Krime te Renda me Vendimin nr. 68 date 26/11/2008 ka **vendosur prishjen e vendimit nr.50 datë 29/07/2008** te Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda-Tirane dhe kthimin e ceshtjes **per rigjykim** ne po ate gjykate me tjetër trup gjykues.

Aktualisht çështja penale ndodhet në gjykim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë pasi ndaj Vendimit të sipërcituar, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda është bërë rekurs.

Mbi bazën e fakteve të mësipërme **gjykata analizon rrethanat e çështjes dhe mbështetur n parashikimin e neneve 3, 4 dhe 13 të ligjit 9284** « Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar », dhe vlereson se :

Së pari :Lidhur me subjektet e kësaj çështjeje mbi pasuritë e të cilëve mund të shtrije efektet ligji 9284, Gjykata konkludon se procedimi i filluar në vitin 2005, në të cilin është marrë me cilësine e të pandehurit edhe N.C, është ende në gjykim, se pas Gjykimit të çështjes në gjykatën e Apelit, ndonëse është vendosur prishja e Vendimit të

Gjykatës së Shkqallës së parë, duke u urdheruar rigjykimi i kësaj çështjeje, të pandehurit në atë proces mbeten përsëri « të dyshuar » për kryerjen e veprave penale për të cilat janë akuzuar.

Për rrjedhojë, në gjëndjen aktuale të procedimit penal, **edhe N.C,** është me statusin e të pandehurit për të gjitha veprat penale për të cilat akuzohet, pra **është i dyshuar se ka konsumuar elementët e veprave penale duke përfshirë edhe ato të parashikuara nga nenet 333/a/1 e 334/1 të K.Penal.**

Në bazë të provave të paraqitura nga akuza në këtë gjykim, ndryshe nga sa pretendon mbrojtja, **Gjykata çmon se për të pandehurin N.C, ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova,** se ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet (si « Falsifikimit të dokumentave », »Falsifikimit të letërnjoftimeve », »Falsifikimit të vulave, stampave », « Dhenie ndihmë për kalimin e paligjeshëm të kufirit » etj), të cilat i ka kryer në bashkëpunim, **në formën e grupit të strukturuar kriminal.** Gjykata çmon se ka dyshime të bazuara në prova se **i pandehur N.C** ka konsumuar edhe elementet e veprës penale « Krijimit e pjeëmarrjes në grupin e strukturuar kriminal » dhe atë të « Kryerjes së veprave penale nga grupi i strukturuar kriminal » të parashikuara nga nenet 333 e 334/a të K.Penal **duke përmbushur kriterin e nenit 3/1 pika « a » të ligjit 9284** « Për parandalimin dhe goditjen e Krimit të Organizuar ».

Në mënyrë të veçantë, gjykata merr në konsideratë aktet që kanë të bëjnë me procedimin penal, provat e paraqitura në gjykim si : Vendim për rregjistrimin e procedimit penal dt. 27.10.2008; Vendim për rregjistrimin e procedimit penal dt. 01.08.2005; Vendim rregjistrimi emri personit dt. 6.10.2005; dt.7.06.2006 dhe atë të datës 23.6.2006; Urdher për disponimin e proves material dt. 12.10.2005; dt. 12.10.2005; Proces verbal për sekuestrimin e proves material dt. 7.10.2005;Vendim për vleresimin e sekuestros dt. 7.10.2005; Vendim mbi vleftesimin e ndalimit dhe caktim mase sigurimi Nr. 160 dt. 9.10.2005;Vendim për caktim mase sigurimi nr. 96 dt. 21.4.2006;Vendim mbi caktimin e mases se sgrimit nr. 95 dt. 22.04.2006; Vendim vleftesim ndalimi nr.164 dt. 09.10.2005; Vendim caktim mase sigurimi Nr. 95 dt. 22.04.2006.

Vendim per vleftesim ndalimi Nr. 164 dt. 9.10.2005;Vendim per vleftesim ndalimi nr. 168 dt. 9.10.2005;etj

Gjykata thekson se në marrjen e këtij vendimi, lidhur me kriterin e percaktuar në nenin 3/1 të K.Pr.Penale për subjektet mbi të cilët vepron ligji 9284, posaçërisht mban në konsideratë përmbajtjen, arsyetimin e Vendimeve gjyqësore me të cilat **është caktuar masa e sigurimit të të pandehurit N.C.** Fakti se i pandehuri N.C tashmë nuk është me masën e sigurimit « arrest ne burg », është rrjedhojë e tejzgjatjes së çështjes ne hetim e gjykim duke kaluar afatet e parshikuara në ligjin procedural për paraburgimin dhe jo me ekzistencen ose jo te « dyshimit të arsyeshëm » për kryrjen prej tij te veprave penale për të cilat akuzohet.

Në këto kushte, ndonëse çështja penale për të cilën është hetuar i pandehuri N.C dhe bashkëpunëtorët e tij, është ende në gjykim dhe se për këtë shtetas **nuk ka një vendim penal të formës së prere që të vërtetojë fajësinë e tij për akuzat e ngritura**, gjykata çmon se pretendimi i mbrojtjes se po shkelet parimi i « prezumimit të pafajësisë » nuk qëndron.

Ligji parandalues, nuk ndjek parimet dhe kriteret e ligjit penal e proceduralo-penal. Sipas këtij ligji është e mjaftueshme ekzistenca e « **dyshimit të arsyeshëm të mbështetura në prova** » që subjekti të ketë konsumuar elementët e një vepre penale nga ato që parashikon neni 3/1 i ligjit, që jo vetëm i dyshuari, por edhe të afërmit e tij të gjinisë që përfshihen në pikat « a », « b », « c » të paragrafit të dytë të nenit 3, të jenë subjekte të ligjit.

Prandaj gjykata çmon se hetimi pasuror i kryer nga organi i prokurorisë për të pandehurin N.C dhe të afërmit e tij **V.C(bashkëshortja), I.C(babai) dhe SH.C(Nëna)**, është i ligjshëm dhe se këta persona në bazë të pikave « a » dhe « c » të paragrafit të dytë të nenit 3 janë subjekt i ligjit parandalues.

Me këtë rast gjykata sqaron se qënia si subjekt e të dyshuarit Nikolin Cako dhe të afërmeve të tij, nuk është e lidhur me ekzistencën ose jo si subjekte të tillë edhe të bashkëpunëtorëve të tjerë të të pandehurit Nikolin, në kryerjen e veprave penale për të cilat janë akuzuar e ndodhen në gjykim, sikundër pretendoi mbrojtja.

Është e drejte e organit të Prokurorisë të verifikojë e kryeje hetimin pasuror të subjekteve që plotësojnë kriterin e nenit 3/1 pika « a » të ligjit 9284 dhe kur vlerëson se ekzistojnë edhe kriteret e tjera të këtij ligji, mund të kërkojë veprimin e tij.

Pra, gjykata vlerëson se i pandehuri **N.C** dhe të afërmit e gjinisë së tij **V, Sh dhe I.C, janë subjekte të ligji 9284**, se me të drejtë akuza ka kryer hetimin pasuror të tyre dhe se akuza ka tagër të kërkojë sekuestrimin e konfiskimin e pasurive që gjënden në pronësi të këtyre subjekteve.

Subjekte te ketij procesi gjyqesore me cilësinë e **Personit të Tretë janë edhe bashkëshortët L.F dhe A.F**, ndonëse nuk kanë ndonjë lidhje gjinie me të dyshuarin N.

Pjesëmarrje e tyre ne kete gjykim është rrjedhojë e thirrjes me cilësinë e personit të Tretë sipas orientimeve të Gjykatës së Apelit dhe në zbatim të nenit 16 të Ligjit 9284, pasi kanë interesa per njëren prej pasurive objekt gjykimi, pikërisht për apartamentin në rrugën XXXX

Së dyti : Lidhur me rrethin e pasurive nga hetimi gjyqësor rezultoi se i pandehuri N.C dhe personat e afërt të tij, respektivisht bashkëshortja dhe prindërit, V.C, I.C dhe SH.C, kanë qënë e janë pronarë të pasurive objekt gjykimi, sipas kërkesës për gjykim.

Ndryshe nga sa pretendoi mbrojtja, gjykata cmon se edhe per pasurine ne rrugën XXXX pretendimi I akuzes se duhet te perfshihet ne rrethin e sendeve te dyshuara sit e vene nga veprimtraj kriminale e te dyshuarit N, eshte I drejte, por vendosja e sekuestros ose jo mbi kete pasuri do te shqyrtohet nga gjykata sipas rrethanave te ceshtjhes e provave te paraqitura nga palet.

Mbrojtja dhe i pandehuri N pretendojne se apartamenti ne rrugen XXXX, pallati 2, shkalla 9, ap.97, nuk është prone e të pandehurit Nikolin, se kontrata e dates 17.02.2000 para noteres, ka qënë fiktive dhe se kjo pasuri është prone e personit që e ka të rregjistruar aktualisht në emrin e tij, LF.

Mbrojtja paraqiti prova me dëshmitarë për te provuar këtë pretendim, **dëshminë e dëshmitares RR.P** e cila dëshmoi se personat e trete A e L.F janë vajza e dhëndërri i saj; se A dhe L jane prej 10 vjetesh ne Amerike se ata kane shtepine ne XXXX, pallati eshte parafabrikat, kat

i pare e se kjo pasuri eshte administruar nga bashkëshorti I saj I cili mblidhte qerane etj, nuk e vlerëson tërësisht të besueshme.

Posacërisht gjykata nuk mund ta marrë në konsiderate dëshminë e saj lidhur me pronësinë e banesës pasi në bazë të nenit 232 të K.Pr.Civile, nuk mund të lejohet prova me dëshmitarë kundër ose tej përmbajtjes së një akti zyrtar, **sic është edhe kontrata nr 493/200 datë 17.02.2000**, kur I pandehuri N ka blerë banesën në rrugën XXX nga L e A.F.

Ndërsa dëshmitari A.T, I kërkuar nga akuza, deklaroi ndër të tjera se banon në pallatin e ri që prej 3 vjetësh se me pare ka banuar në një shtëpi me qera, parafabrikat, në katin e parë. Atje ka qendruar 2 vjet tek ajo shtëpi që gjëndet në rrugën XXX se vlerën e qerasë ia paguan një burri të moshura, por dëshmitari nuk dëshmoi as emrin e qeradhësës e as të personit që merrte vlerën e qerasë.

Në këto kushte lidhur me këtë pasuri gjykata merr në konsideratë përmbajtjen e kontratës noteriale të shitjes **nr 493/200 datë 17.02.2000, vullnetin e paleve të shprehur në këtë kontratë.**

Ndryshe nga sa pretendon mbrojtja, **gjykata vlerëson se kontrata për kalimin e pronës së pasurisë në rrugën "XXX" midis paleve shitesë L.F dhe paleve blerëse N.C është e vlefshme** dhe pavaresisht se ajo nuk është rregjistruara në Zyren e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme prodhon efekte të plota juridike mes paleve që e kanë nënshkruara.

Prandaj, gjykata duke marrë në konsideratë edhe orientimin e **Vendimit Unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 01 datë 06.01.2009**, vlerëson se i pandehuri N.C është pronar i kësaj pasurie, se kjo pasuri duhet të përfshihet në rrethin e pasurive për të cilat i pandehuri ka detyrimin që të provojë ligjshmerinë e krijimit të saj.

Ndërsa, **lidhur me pretendimin përfundimtar të akuzës**, për të sekuestruar edhe **paisjet e sendet që gjënden në banesat objekt** të shqyrtimit gjyqësor, **Gjykata vlerëson se qendrimi i akuzës vjen në kundërshtim me parashikimin e nenit 185 të K.Pr.Civile.** Sendet e paisjet e një banesë kanë vlerën e tyre për të cilën as nuk është bërë verifikimi në fazën e hetimeve paraprake e as nuk janë objekt të kërkesës për sekuestrim.

Në këto kushte, Prokurori mund të kërkonte gjatë fazës së hetimit gjyqësor ndryshimin e objektit të padisë (të kërkesës) sipas parashikimit të

nenit 185 ë K.Pr.Civile, por një kërkim të tillë nuk mund ta pretendojë vetëm në diskutimin përfundimtar, kur hetimi gjyqësor ishte mbyllur.

Prandaj, Gjykata nuk e merr ne konsiderate pretendimin e akuzës të paraqitur vetëm në diskutim përfundimtar lidhur me sekuestrimin e paisjeve dhe të sendeve që gjënden në banësat objekt shqyrtimi gjyqësor, pasi vlereson se nuk është ne objektin e kërkeses për gjykim.

Lidhur me ligjeshmerine e prones objekt shqyrtimi gjyqësor dhe **justifikimin e vleres së saj** nga mbrojtja dhe i pandehur e të afërmit e tij, gjatë gjykimit rezultoi se :

Prokurori pretendon se i pandehuri dhe të afërmit e tij nuk e justifikuan pasurinë e vënë në emër të tyre. Edhe nga aktiviteti tregëtar i kryer prej të pandehurit N dhe të afërmit të tij, të ardhurat e realizuara nuk mund të përfshihen në justifikimin e pasurive të mësipërme sepse ata kanë disponuar shuma të hollash të cilat nuk është bërë e mundur të gjënden e sekuestrohen sepse janë fshehur prej tyre pas fillimit të cështjes penale ndaj të pandehurit N.C.

Kështu prokurori pretendon se në datën 13.12.2003 shtetasja V.C, i ka dhënë shtetasit H.D një herë shumën prej 3 000 000 lekësh në këmbim të një sipërfaqe toke prej 300 m² dhe një herë shumën prej 1 000 000 lekësh në këmbim të një sipërfaqe toke prej 200 m².

Gjithashtu, sipas akuzës personi i Trete I.C, në datën 13.09.2004 ka lidhur një kontratë sipërmarrje me Shoqërinë XXX, Sh.p.k. për blerjen e një dyqani dhe i ka dhënë një shumë prej 50 000 Euro.

Kjo shumë, sipas akuzës, është tërhequr më pas në datën 12.07.2005 nga shtetasi I.C në shumën 40 000 Euro duke anuluar kontratën e sipërmarrjes shumë e cila nuk është gjendur e seksuestruar.

Pra akuza pretendon se personi i Trete V.C ka pasur në zotërim në muajin Dhjetor 2003 shumën prej 4 000 000 lekësh, ndërsa dhe personi i Trete I.C ka dhënë shumën prej 50 000 Eurosh në datën 13.09.2004.

Prokurori pretendon se nga verifikimet e kryera në fazën e hetimit pasuror **si dhe nga gjykimi i cështjes** rezulton që i pandehuri N.C dhe personat e Trete V, Sh dhe I.C **nuk e justifikuan** blerjen dhe posedimin e këtyre pasurive, **prandaj Prokurori kërkoi pranimin e kërkeses dhe sekuestrimin e pasurive.** Madje në kërkimin përfundimtar prokurori,

zgjeroi rrethin e sendeve objket gjykimi pasi **pretendoj sekuestrimin e banësave së bashku me paisjet e sendet që kanë brënda.**

Mbrojtja e të pandehurit N.C dhe e personave te trete SH.C, I.C dhe V.C pretendon se:

- Me përjashtim të pasurisë “Apartament i ndodhur në rrugën XXXX”, pall. 2 shkalla 9 ap 97., të gjitha pasuritë e tjera të sekuestruara paraprakisht nga Gjykata, janë pronë e ligjshme e pronarëve të tyre, se ato i kanë fituar në menyre te ligjshme nga puna fillimisht si emigrant në shtetin Grek e të pandehurit N.C dhe e personave te Tretë dhe më pas nga aktiviteti tregëtar që ai dhe familja e tij ka ushtruar në Tiranë.

Sipas mbrojtjes është krejt antiligjore dhe e paprovuar kërkesa e organi procedues për konfiskimin e **apartamentit** që perdoret si strehë dhe banim të familjes N.C, **ndodhur në Tiranë në Rr. XXXXXXXXXXXX prej 130 metra katriorë, Z. Kadastral XXX me nr. regjistri XXX, së bashku me paisjet në apartament,** megjithëse kjo pasuri, sipas mbrojtjes, u vërtetua gjatë gjykimit se është fituar nga burime dhe rrugë të ligjshme te ardhurash, pasi kjo banesë është blerë në vitin 1998 dhe në vitin 2000 është bërë tjetërsimi I kësaj banese.

Sipas mbrojtjes kërkesa e Prokurorit për sekuestrimin e apartamenteve të blerë para vitit 2005, është në kundërshtim me vetë praktikën unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së lartë dhe pikërisht me Vendimin Unifikues nr.01 dt. 25.01.2007, i cili përcakton se objekt i ligjit parandalues janë vetëm pasuritë e krijuara gjatë periudhës që i pandehuri dyshohet se është marrë me veprimtari kriminale.

Sipas mbrojtjes e pa mbështetur në ligj dhe në prova është kërkimi nga prokuroria për të sekuestruar mjetet monetare dhe valutare të gjendura në agjensinë “XXX”, si dhe kërkesa për sekuestrimin e dy mjeteve në pronësi të bashkëshorteve N e V.C sepse në gjykim u provua aktiviteti tregëtar e fitimprures i të pandehurit e familjarëve të tij në këtë shoqëri.

Mbrojtja pretendon se edhe për sekuestron e garsonieres prej 30 metra katror, ndodhur në Tiranë, në pronësi të SH.C pasi edhe kjo banesë është perfituar dhe vërtetohet nga të ardhurat dhe burime të ligjshme dhe është blerë shumë kohë para se te filloj dhe rregjistrohet ceshtja penale në emer të N.C.

Vlera e kësaj pasurie sipas mbrojes, është 100 000 lekë dhe I përgjigjet shumës së depozitës të bashkëshortit të saj I.C dhe që është tërhequr prej tij.

E padrejtë është kërkesa e prokurorisë për sekuestrimin e sepse ato kanë qënë pjesë e aktivitetit të ligjshëm tregëtar dhe vler e tyre është përballuar nga të ardhurat e të pandehurit dhe bashkëshortes së tij.

Mbrojtja pretendon se prokurori gabon edhe duke kërkuar sekuestro lidhur me banesën e paregjistruar në ZVRPP Tiranë ndodhur në XXXXX pall. 2 shk. 9 ap. 97 blerë me kontratën e datës 17.02.2000 që është në pronësi të shtetasit L.F, se kontrata e shitjes është fiktive pasi i pandehuri N do të aplikontë për vizë në SHBA dhe i duhet një pasuri për lehtësi dokumentash.

Pra në tërsi, mbrojtja pretendon se kërkesa e akuzës për sekuestrimin e pasurive objekt gjykimi është e pambështetur dhe në bazë të provave të sjella prej saj në këtë gjykim, pretendon se justifikohet vlera e pasurisë objekt I këtij gjykimi.

Gjykata, shqyrtoi çështjen mbi bazën e parimeve të procedurës civile, duke lejuar palët në paraqitjen e provave e debatin për to.

Lidhur me ligjshmerine e krijimit te pronave objekt I kerkeses per gjykim, gjykata ve ne diskutim vleren e tyre dhe aktivitetin ekonomik e tregetar te zhvilluar ne teresi nga i pandehuri N dhe te afermit e tij, e ne vecanti gjykata analizon te ardhurat e deklaruar te fituara prej tij, ne periudhen pasi është krijuar shoqëria “XXX” sepse, sipas akuzes, nëpërmjet veprimtraise se kesaj shoqerie, ka dyshime se I pandehur ka kryer aktivitetin criminal dhe ka perfituar te ardhura te paligjeshme.

Gjatë hetimit gjyqsor të çështjes, mbrojtjes dhe të dyshuarit N.C si dhe të afërmve të tij V.C, I.C dhe SH.C, ndonëse jemi në fazën e shqyrtimit të kërkesës për sekuestrim, ju dha akses i plotë në përmbushjen e parimit se “Barra e provës” për të justifikuar pasurinë, sipas ligjin parandalues, bie mbi subjektet ndaj të cilëve vepron ky ligj.

Lidhur më pretendimin e mbrojtjes për punësimin si emigrant në shtetin Grek, gjykata dëgjoi e vlerëson dëshmitë e dëshmitarëve të

paraqitura nga mbrojtja, të cilët provojnë pretendimin për krijimin e të ardhurave gjatë periudhes 1991 deri në 1998.

Kështu, dëshmitaret A.M, F.M, H.K, S.K deshmojne per menyren e emigrimit dhe punen e kryer nga I pandehur N ne Greqi. Prej ketyre dëshmime, **Gjykata bindet** se i pandehuri N.C ka punuar si emigrant ne Greqi, në periudhen 1991-1998 dhe se gjatë punës ka siguruar të ardhura.

Gjykata, ndryshe nga sa pretendon Prokurori, merr në konsideratë faktet objektive që kanë ndodhur në vendin tonë në periudhen e viteve 90' madje edhe në vijim, kur një pjesë e konsiderueshme e shtetasve tane kanë kaluar ilegalisht kufirin shtetëror me Greqine dhe kane punuar si emigrante te paligjeshme, prandaj I konsideron të besueshme dëshmitë e cituara më sipër të dëshmitarëve për faktin e punësimit të të pandehurit N si emigrant i paligjeshmëm ne Greqi në periudhën 1991-1998.

Pretendimet e mbrojtjes gjenden te provuara nga dëshmitë e dëshmitarëve të pyetur në seancë gjyqësore, ndonëse për sasinë e të ardhurave të grumbulluara, **gjykata vlereson se në këto dëshmi ka edhe subjektivizëm**, por që nuk influencojnë në zgjidhjen e çështjes.

Mbrojtja dhe i dyshuari N pretendojnë se nga aktiviteti tregëtar i zhvilluar në Tirane në vitet 1998-2005, justifikohet pasuria e gjithë pasuria e pretenduar nga akuaza në këtë gjykim për t'u sekuestruar, por nga hetimi gjyqësor nuk rezulton plotesisht kështu.

Nga provat e paraqitura në séance gjyqësore, provohet se ne vitin 1998 i dyshuari N është vendosur familjarisht në Tiranë duke marrë shtëpi me qera tek dëshmitari B.T i cili deshmoi se: "i pandehuri N.C, ne vitin 1998, i ka kerkuar per te mare shtepin me qera qe eshte tek rruga XXX. Ai vinte nga Geqia dhe shtepine e mori me qera ne shumen 200 mije leke(të vjetra).

Pas vendosjes në shtëpinë me qera provohet se i dyshuari N ka bërë përpjekje për t'u ingranuar në jeten e kryeqytetit.

Provohet se me Vendim nr 13378 datë 03.03.2000, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është rregjistruar si person fizik dhe në datën 15.05.2000 është rregjistruar në organin Tatimor me objekt "Trasport mallrash e udhetarësh" me xhiro vjetore 2 000 000 lekë në vit.

Me të njëjtin status, ne datën 23.10.2002 është licencuar nga Bashkia Tiranë si “Taksi”, për transport udhëtarësh, brënda e jashtë qytetase.

Gjykata vlerëson se I dyshuari N, në periudhën 2000 deri ne vitin 2002, ka ushtruar aktivitet tregëtar, të llojit të “biznesit të vogël”, fillimisht më transport mallrash e udhëtarësh, me furgon e më pas si “taksi”, dhe se të ardhurat nga ky aktivitet, **ndryshe nga sa pretendon mbrojtja, gjykata vlerëson se nuk i kalojnë nevojat për përballimin e jetës së përditëshme** për ushqim e veshmbathje të familjes së tij, pra se në këtë periudhë ai nuk ka mundur të shtojë pasuri nga puna e ligjeshme që kryente.

Kështu, provohet në gjykim se, me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr 2787 datë 07.06.2002, i pandehuri N.C ka themeluar shoqërinë “XXX” sh.p.k. me objekt “Agjenci turistike”. Provohet se në datën 09.08.2002 është paisur me Liçencen Nr X me objekt “Agjenci shitje biletash ajrore”, për shoqërinë “XXX” sh.p.k. dhe gjithnjë ka ushtruar aktivitet të licencuar si “biznes i vogël”. Për vitin 2004 I pandehuri ka deklaruar për shoqërinë “XXXX” dhe ka paguar tatim për qarkullimin (Xhiro) vjetore e të ardhurave totale të shoqërisë në shumën 5 000 000 lekë.

Për të justifikuar ligjshmërinë e pasurisë që kërkohet të sekuestrohet, dhe për të provuar të ardhurat nga aktiviteti tregëtar I të pandehurit N e familjareve të tij, mbrojtja kërkoj edhe marrjen e provave me dëshmitarë.

Kështu, dëshmitarja **A.T** dëshmoi se ka punuar te agjensia XXXX me pronar N.C Ajo deklaroi se “Kam filluar ne Shtator 2004 deri ne Tetor 2006 kur u mbyll agjensia. Ne agjensi ka qene agjente e shitjes se biletave dhe tip administratore e zyres. Ajo deklaroi se meqenese agjensia ndodhej ne fillim te rruges se ambasadave pervec funksionit kryesor qe kishte shitje biletash avioni dhe trageti, ofronte dhe sherbime te tjera qe ishin shkembim i parave, me manigram, prerje siguracione automjeti, dhe sigurim shendetesor, ne pergjithese, e kyesisht per ata qe shkonin jashte. Sherbime fotokopje, faksi qe ishin te shumta dhe plotesim formularesh per ne ambasada, ne forme asistence, dua te shtoj edhe turizmin. Cuarja e pushuesve neper hotele jashte shtetit dhe ne udhetime turistike. Numer te sakt biletash nuk mund te them por ka qene shume. Nje shifer totale

shkonte tek 50-60 milion leke te vjetra. Per te gjitha periudhat. te ardhurat qe thashe ishin mujore se ishin prurje te te gjitha zerave. Shifra qe thashe ishte xhiro bashke me shpenzimet. Fitimi ishte hiqen te ardhurat e te punesuarve, qeraja, e fitimi ishte i konsiderueshem. Detyrimi qe ishte ne shtet ishin pagesat qe beheshin nje here ne vit si biznes.

Ndërsa dëshmitari **M.I** deklaroi në seancë gjyqësore se jeton ne Kabash dhe se familjen e Nikolinit e njeh dhe se kjo familje ka perfitur nga ligji per token dhe se ka ne perdorim token e I.C. Dëshmitari dëshmon se “ e kam mare une gjithesej 18 dynym qe nga viti 1992 dhe I jep nje qera familjes se N në shumen prej 200 mije leke në vit.

Deshmitari **H.D** (vjeherri i të pandehurt N.C) deshmoi se vajzes, V.D (C) i kam dhene edhe toke edhe para. Token ja kam dhene tek XXX me dokumenta. I kam dhene 400 metra katror. I kam dhene mbi 70-75 milion leke(të vjetra). Kane qene me qera tek XXX. Kur mbaroj qera ne 1999, i kam dhene leket. Ka qene 1998-1999. Kam 36 dynym dhe 800 metra toke.

Gjykata e merr me shumë rezerve dëshminë e këtij dëshmitari sepse jo vetëm është i afërt i gjinisë, babai i Personit te Tretë V.C dhe vjehër i të pandehurit N, por edhe sepse ishte kontradiktor e i pabesueshëm.

Po kështu me rezerve merr gjykata edhe dëshminë e dëshmitares A.T pasi, në bazë të nenit 232 të K.Pr.Civile, nuk mund të provohen me dëshmitarë të ardhurat e realizuara nga aktiviteti tregetar, per me tepër kur të dhënat e dëshmuara prej saj nuk përputhen me satusine e aktivitetit të shoqërisë XXXX e cila provohet se ka ushtruar veprimtarinë si “Biznesi i vogël”

Ne baze te provave te marra per shqyrtim, lidhur me pasuritë e pretenduara nga akuza për sekuestrim, **gjykata konkludon se kërkesa e Prokurorit duhet të pranohet vetëm pjesërisht.**

Ndryshe nga sa pretendon akuza, lidhur me pasuritë objekt gjykimi, u provua se një pjesë e tyre janë vënë si rrjedhojë e punës së ndershme të të pandehurit N dhe Personave te Trete, gjini e afërt e tij.

Gjykata cmon se në bazë të nenit 3/3 të ligjit 9284 dhe Vendimit Unifikues të Kolegjeve te Bashkuara te Gjykatës së Lartë nr 01 datë 25.01.2007, masat e ligjit parandalues nuk mund të shtrihen mbi pasuritë

e të pandehurit N dhe të afërmeve të tij, në rastet kur provohet se janë krijuar në një periudhë kur i pandehuri objektivisht nuk mund të merrej me veprimtari kriminale për të cilën akuzohet, e posaçërisht me “kontrabandimin e njerëzve”, për qëllime fitimi, nëpërmjet rrugëve ajrore që I siguron të nëpërmjet shoqërisë me objekt “Agjenci shitje biletash ajrore”.

Sipas provave të sjella edhe nga akuza në këtë gjykim, provohet tej cdo dyshimi se I pandehuri N.C e ka krijuar shoqërinë “XXX” sh.p.k në Qërshor 2002 dhe në Gusht 2002 është licencuar për të ushtruar aktitetin si “Agjenci udhëtimi”

Në këto kushte gjykata cmon se për pasuritë e krijuara përpara muajit Gusht 2002, kërkesa e akuzës për ti vendosur në sekuestro, nuk mund të pranohet sepse blerja e këtyre pasurive nuk ka të bëjë me përfitimet e nxjerra nga I pandehuri N.C nga veprimtaria e dyshuar si kriminale që ai ka konsumuar duke përdorur si fasadë shoqërinë “XXX” sh.p.k.

Në këto kushte gjykata cmon se kërkesa e akuzës për sekuestrimin e pasurisë “apartament’ ndodhur në rrugën XXX” e blerë në vitin 2000 dhe e regjistruar në emër të të pandehurit N.C, nuk mund të pranohet sepse vjen në kundërshtim me përmbajtjen e nenit 3/3 të ligjit parandalues.

Madje, nga provat e sjella për gjykim, Gjykata, për më tepër, bindet se i pandehuri N, në periudhën 1991-1998, nga të ardhurat e siguruar prej punës si emigrant e justifikon blerjen, në datën 13.04.2000, të apartamentit në Rrugën “XXXX, ndodhur në zonën kadastrale nr 8370 e numër pasurie 9/75. Provohet në gjykim se kjo pasuri është blerë tek shoqëria e ndërtimit “XXX” në shumën 2 100 000 lekë në një kohë kur, sic u arsyetua më lart, nuk ka asnjë indicje se i pandehuri N merrej me ndonjë veprimtari kriminale.

Prandaj kërkesa e akuzës për sekuestrimin e pasurisë apartamentit në Rrugën “XXXX, në emër të të pandehurit N.C, ndodhur në zonën kadastrale nr 8370 e numër pasurie 9/75, duhet të rrëzohet.

E pambështetur ne prova e ne ligj u gjend edhe kërkesa e akuzës për sekuestrimin e pasurisë “Apartament” në rrugën “XXXX”, Pallati 2

shkalla 9 ap 97, që gjëndet I rregjistruar ende në emër te personit të Tretë L.F.

Ndryshe nga sa pretendon mbrojtja, Gjykata, sic u arsyetua me siper, cmon se pronar i kësaj pasurie është I pandehuri N.C I cili e ka blerë këtë pasuri më kontratë noteriale.

Pretendimet e mbrojtjes se kjo kontratë është bërë fiktive si dhe dëshmia e dëshmitares RR.P, nuk merren në konsideratë, pasi kontrata noteriale konsiderohet provë e plotë dhe nuk mund të kundërshtohet me dëshmitarë.

Lidhur me parashikimin e nenit 83 të K.Civil, gjykata cmon se mosrregjistrimi nuk passjell në mënyrë të drejtpërdrejtë pavlefshmërinë e kontratës së shitjes së pasurisë së paluajtëshme.

Ndonëse gjykata zbatoi orientimin e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda për thirrjen me cilësinë e Personit te Tretë të shitësit të pasurisë L.F dhe bashkëshortes së tij A.F, ata nuk u paraqitën edhe sepse nuk kanë interes për këtë pronë, pasi e kanë marrë vlerën e çmimit të shitjes, ndërsa detyrimi për rregjistrim ka qënë i blerësit N.

Megjithëse gjykata, konkludon se **kërkesa e Prokurorit për sekuestrimin e kesaj pasurie është e paligjëshme**. Në gjykim u provua se cmimi për fitimin e kësaj pasurie është paguar nga i pandehuri N, shitësit L.F, në datën 17.02.2000. Sic u arsyetua më lart, për këtë periudhe kohe nuk ka asnjë indicje se merrej me aktivitetin kriminal për të cilin është i dyshuar pasi shoqëria XXXX, nëpërmjet së cilës është mbuluar veprimtaria kriminale e kotrabandimit të personave, është krijuar rreth dy vjet më vonë, në 07.06.2002 ndërsa licencën si “Agjenci shitje biletash ajrore” e ka marrë më 09 Gusht 2002.

Lidhur me pasuritë e tjera të evidentuara se gjënden ne pronësi të të pandehurit Nikolin ose Personave te Trete V.C, SH.C dhe I.C, **gjykata cmon se provohet se janë krijuar në periudhën kur ka funksionuar shoqëria “XXXX” shj.p.k.**, prandaj për ligjshmërine e krijimit të ketyre pasurive merret në konsideratë aktiviteti i ligjshëm tregetar i të pandehurit dhe familjarëve të tij si dhe gjithë lëvizjet financiare të kryera prej tyre gjatë periudhës Gusht 2002- Dhjetor 2005 në raport me veprimtarinë e dyshuar si kriminale që I pandehuri N e bashkëpunëtorët e tij kanë kryer nëpërmjet kësaj shoqërie.

Ndryshe nga sa pretendon mbrojtja, në gjykim u provua se aktiviteti tregëtar i shoqërisë “XXX” ka qënë I llojit “biznes I vogël” dhe se xhiroja vjetore(qarkullimi vjetor) sipas vetdeklarimit në organet tatimore i këtij aktiviteti ka qënë 5 000 000(pesëmiljon) lekë me kufirin maksimal 7-8 milion lekë.

Për të verifikuar pretendimet e mbrojtjes lidhur me fitimin e realizuar, meqënëse u pretendua se janë bërë bilancë vjetore të aktivitetit tregëtar, dhe se mbrojtja nuk po mund ti merrte ato ne administrate, me kërkesën e mbrojtjes, gjykata kërkoi informacion Drejtorisë së Tatimeve Tiranë dhe nga organi përgjegjës në Bashkinë Tiranë.

Sipas shkresës nr. 7470/1 datë 19.12.2009 të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Tiranë rezulton se shtetasi NC rezulton I regjistruar si administrator I shoqërisë “XXXX” shpk me xhiro vjetore 7-8 milion dhe kjo shoqëri rezulton me detyrime të pashlyera në shumën 825 063 lekë. Ky shtetas figuron me statusin e mbyllur për aktivitetin Bilardo në rrugën XXX ndërsa për aktivitetin Transport udhëtarësh nuk është I regjistruar. Shtetasja V.C rezulton me aktivitet studio grafike dhe një aktivitet bar kafe e mbyllur. Shtetasit I dhe SH.C nuk rezultojnë të kenë të regjistruar aktivitet privat.

Mbrojtja, pasi u njoh më këtë përgjigje, hoqi dore nga përgjigja prej Drejtorisë së Tatimeve Tiranë, madje edhe pas ardhjes së kësaj përgjigjeje, mbrojtja nuk kërkoi të ricelej hetimi gjyqësor që të përfshihej në debatin e provave.

Nga tërësia e provave rezulton se I pandehuri N ka ushtruar aktivitet të ligjëshëm si “biznes i vogël” se ka paguar tatim të thjeshtuar dhe nuk ka patur detyrim të bëjë balance vjetore.

Tek pasuritë e grumbullura nga I pandehuri N dhe Personat e Tretë në periudhën e veprimtarisë së shoqërisë “XXX”, gjykata vlerëson se duhet të përfshihet jo vetem apartamenti në rrugën “XXX” I rregjistruara në emër të Personit të trete SH.C, automjetet e rregjistruara në emër te të pandehurit N dhe bashkëshortes së tij V, depozitat bankare ne emër të kësaj të fundit dhe Personit te Tretë I.C, por edhe **kunder vlefta e pasurisë së paluajteshme sipas kontratës së porosise se dtës 13.09.2004, të lidhur me shoqërine ndertuese XXX sh.p.k.**

Rezulton se për lidhjen e kësaj kontrate është paguar shuma 50 000 euro dhe se është dhënë kompanisë së ndërtimit edhe një automjet i të pandehurit N, I cili është konvertuar nga sipërmarrësi, në vlerën 25 000 euro për llogari të pororsitësit I.

Sipas dokumenteve të noterizuar në datën 20.12.2005 me numrin 5367, rezulton se porositësi I.C është tërhequr nga kontrata e porosisë dhe ka marrë si **kundërvlerë shumën 40 000 euro**. Edhe lidhur me vlerën e automjetit shoqëria e ndërtimit ka kthyer të pandehurit N.C **shumën prej 12 000 euro**.

Ndonëse shuma prej 75 000 euro(50 000 +25 000) që I është paguar firmës ndërtuese me 13.09.2004 apo edhe vlera e kthyer prej saj 52 000 euro, **nuk janë objekt I drejtperdrejte I këtij gjykimi**, gjykata i vlerëson ato me qëllim që të konkludojë lidhur me ligjshmërinë e pasurive objekt gjykimi dhe pretendimin e mbrojtjes e të dyshuarit N për justifikimin e vlerës së pasurisë që kërkohet të sekuestrohet në këtë gjykim..

Personi I Tretë I.C, nuk provohet se ka pasur aktivitet tregtar që të justifikojë shumën e kontratës së pororsise, prandaj gjykata cmon se kontrata e sipërmarrjes e dates 13.09.2004, **është rrjedhojë e aktiviteteve të ligjshme e të paligjshme të të pandehurit N.C**.

Nga tërësia e aktivitetit tregtar si “biznes i vogel” I ushtruara nga I pandehuri N.C apo edhe nga personi I trette V.C, gjykata cmon se vlera e marrë nga I pandehuri N dhe Personi I Tretë I, në shumën 52 000 euro(40 000 +12 000), është shumë më e madhe se sa fitimi I ligjshëm që ata kanë realizuar gjatë periudhës 2002-2005.

Vlera e mësipërme nuk është objekt gjykimi sepse nuk është gjëndur në kohën e duhur dhe më pas është tërhequr prej Personit të Tretë I, por kjo vlerë monetare ndikon në bindjen e gjykatës se gjatë periudhës 2002-2005 I pandehuri ka siguruar përfitime të paligjshme nga aktiviteti kriminal për të cilën dyshohet se e ka kryer.

Ndryshe nga sa pretendon mbrojtja, Gjykata cmon se nga provat që I përkasin hetimit penal, ndonëse rregjistrimi I çështjes penale është bërë në datën 01.08.2005, veprimtaria kriminale e të pandehurit është shtrirë shume kohe më parë. Nisur nga natyra e aktivitetit të shoqërisë “XXX” si dhe nga natyra e vepres penale të “Dhenie ndihmë për kalim të

paligjëshëm të kufirit” sipas nenit 298 të K.Penal, gjykata vlereson se për pasuritë e vëna në periudhën 2002-2005, i pandehur dhe të afërmit e tij duhet ta justifikojnë ligjshmërinë e krijimit të tyre, gjë që nuk u arrit nga mbrojtja e I pandehur në këtë gjykim. Vlera e gjithë pasurisë së vënë nuk I përgjigjet të ardhurave të deklaruara prej aktivitetit tregetar të pandehurit e të afërmit të tij duke përmbushur kështu kriterin e parashikuar në nenit 13/1 pika “a” për sekuestrimin e pasurive.

Prandaj kërkesa e prokurorit për sekuestrimin e pasurive të vënë nga I pandehur N dhe të afërmit e gjinise së tij, në këtë periudhë dhe që janë objekt i shqyrtimit gjyqësor, duhet të pranohet.

Sipas analizës së provave të sjella nga palet në gjykim, kjo gjykatë vlerëson se pasuria “Apartament” në rrugën XXXX në emër të personit të Tretë SH.C, nuk justifikohet me të ardhurat e ligjshme. Pronorja e pasurisë nuk provoi se mund të krijonte të ardhura nga puna e saj.

Kjo pasuri nuk mund të jete blerë as me depoziten e Personit të Tretë IC sepse provohe se ai ka tërhequr shumën prej 1 000 000 leke, në datën 14.12.2005, ndërkohë që pasuria e sipercituar është blerë me shumë se dy vjet me parë, në datën 19.09.2003 sipas kontratës noteriale nr XXXX

Prandaj gjykata vlerëson se pronar I vertete I kesaj pasurie eshte I dyshuari N.C dhe se ai nuk e justifikon krijimin e saj. Për më tepër, gjykata konstaton se nga hetimi penal rezulton se kjo pasuri ishte në shërbim të aktivitetit kriminal të të pandehurit sepse ishte kthye në laborator për fallsifikimin e dokumenteve me të cilat paiseshin personat e kontrabanduar.

Edhe lidhur me **dy mjetet respektivisht, me targa XXXX. targa XXXX të sekuestruara** gjatë procedimit penal dhe që provohet se janë të regjistruara në pronësi të të pandehurit N dhe **bashkëshortes se tij V, si dhe vlerat monetare të sekuestruara në mjediset e shoqërisë “XXXX”, gjykata cmon se duhet të pranohet kërkesa e prokurorit e se duhet të sekuestrohen edhe sipas nenit 27/1 të ligjit 9284.**

Në kushtet kur Vendimi i gjykes së shkallës së parë është prishur dhe çështja është dërguar për rigjykim, kjo gjykatë vlerëson se ndaj këtyre pasurive duhet të veproje ligji parandalues, por në bazë të nenit 27/2 të ligjit 9284, **zbatimi masës do të pezullohet për të gjithë periudhën e zhvillimit të procedimit penal.**

Edhe lidhur me pasurinë e gjëndur ne emer te personit të Tretë V.C, ne Banken Amerikane, sipas shkreses 05/6329/1 prot date 28.10.2005 që bën fjalë për depozitën ne shumen prej 1970 USD, **kërkesa e akuzës është e drejtë e duhet të pranohet si e ardhur e shtuar në periudhën e veprimtarisë të dyshuar si kriminale të bashkëshortit të saj N.**

Ndërsa në emër të personit të trete, **I.C (babai i të pandehurit N)**, prokurori pretendon se **është gjëndur pasuria :-** Shumën prej 1 036 095 lekë depozituarnë Raiffeisen Bank në llogarinë nr. XXXXX

Mbrojtja pretendon se pjesën prej 1 000 000 lekë personi I Tretë e ka tërhequr nga banka për të blerë garsonieren në rrugën “XXXX” e rregjistruar në emër të bashkëshortes së tij SH.C.

Gjykata konkludon se për këtë pasuri, pretendimet e paleve nuk i përgjigjen provave të marra për shqyrtim në këtë gjykim

Eshte e vërtetë se në Tetor 2005, në emër të Personit të Trëtë I.C ka qënë depozita bankare në shumën prej 1 036 095,44 lekë. Nga shkresa nr 427/1 date 24.02.2006 e bankës Raiffeisen, rezulton se kete shume depozituesi I, ne daten 14.12.2005, e ka pakësuar sepse provohet se ai ka tërhequr shumën prej 1 000 000 lekë. Ne llogari ka mbetur vetem shuma prej 39 184.16 lekë në depozite në favor të personi i Tretë I.C ne Raiffeisen Bank (Agjencia bankare nr 10) në llogarinë Nr.XXXXX.

Gjkata cmon se në këtë depozitë Personi i Tretë, nga momenti i celjes e deri në datën 24.02.2006, ka bërë disa lëvizje dhe se pjesa e mbetur e depozitës është vënë gjatë vitit 2005, kur është derdhur shuma prej 250 000 lekë. Tërheqja e shumës prej 1 000 000 lekë nuk është përdorur pr të blerë pasurinë e pretenduar nga mbrojtja, por pikërisht për tju fshehur veprimet të ligjit parandalues pasi në këtë periudhë i biri tij, i pandehur N gjendej nën masën e sigurimit “Arrest në burg”.

Megjithatë gjykata cmon se në kushtet kur pjesa prej 1 000 000 leke nuk është gjendur, nën masën e sekuestror duhet të mbetet vetem shuma që ka mbetur në depozitë.

Gjykata sqaron se sipas kuptimit te nenit 27 te ligjit 9284, masat e sekuestrimit apo konfiskimit per pasurite e sekuestruara gjate procedimit penal, kane varesi nga ecuria e gjykimit penal dhe disponimi i gjykates penale per pasurite e sekuestruara.

Prandaj për pasuritë e sekuestruar gjatë hetimit të çështjes penale nr 72 të vitit 2005 në të cilën është i dyshuar edhe i pandehuri N.C, bazuar në nenin 27/2 të ligjit 9284, zbatimi i masës së sekuestros duhet të pezullohet gjatë gjithë periudhës së shqyrtimit gjyqësor në ngarkim të tij.

Në përfundim të gjykimit penal, nëse këto pasuri do të konfiskohen me vendim të formës së prere, disponimi i kësaj gjykate ne kete vendim shuhet sipas parashikimit te paragrafit te trete te nenit 27 te ligjit 9284 dhe nëse nëpërmjet gjykimit penal nuk pranohet kërkesa për konfiskim, pasuritë i nënshtrohen vendimit sipas ligjit parandalues, pra sipas disponimit të kësaj gjykate si më poshte i cili behet teresisht i ekzekutueshem.

PER KETO ARSYE

Gjykta mbështetur në parashikimin e neneve 3,13 e 27 të ligjit 9284 si dhe të neneve 306 e vijues te K.Pr.Civile

V E N D O S I

Pranimin e pjesëshëm të kërkesës.

a)Vendosjen nën masën e sekuestros të pasurive si vijon:

1. Apartament ne rrugen XXXXXX nr. 7/3 kati i shtate ne ponesi te personit te trete SH.C, zona kadastrale XXXX.
- 2.Mjetin tip Nissan, me targa XXXX, në pronësi të pandehurit N.C.
3. Mjetin me targa XXX, në pronësi të personit te trete V.C
- 4.Vleta monetare te gjendura ne Agjensine “XXX” Tirane. Shuma 598.200 leke; shuma prej 2700 Euro; shuma prej 40 USD; shuma prej 60 Paund; shuma prej 200 Dhrami
5. Shumen prej 1970 USD e depozituar prej personit të tretë V.C, ne Banken Amerikane te Shqiperise.
6. Shuma prej 39 184.16 lekë, mbetur në depozitë, ne Raiffeisen Bank (Agjencia bankare nr 10) në llogarinë Nr. XXXXX, në favor të personi i Tretë I.C.

b) Rrëzimin e kërkesës së Prokurorit për sekuestrim si të pambështetur në prova e në ligj, si dhe revokimin e masës së sekuestros paraprake mbi pasuritë:

1. Apartament në pronësi të të dyshuarit N.C ndodhur në rrugën XXX zona kadastrale nr. 8370, rregjistri 414 nr rendor 127 në Tiranë.

2. Apartament në pronësi të të dyshuarit N.C, ndodhur në rrugën XXX pall.2 Shkalla 9, Ap.97 i blere me kontraten e dates 17.02.2000, i rregjistruar në Zyrën e Rregjistrimit te pasurive të Paluajtëshme në emër të shitësit L.F.

c) Për pasuritë e sekuestruara sipas pikave 1,2,3,4 të gërmës “a” të këtij vendimi(1.Apartament ne rrugen XXXX nr. 7/3 kati i shtate ne ponesi te personit te trete S.C, zona kadastrale 8370; 2.Mjetin tip Nissan, me tagra XXXXXX, në pronësi të pandehurit N.C; 3. Mjetin me targa TR xxxx F, në pronësi të personit te trete V.C; 4.Vleta monetare te gjendura ne Agjensine XXXX Tirane. Shuma 598.200 leke; shuma prej 2700 Euro; shuma prej 40 USD; shuma prej 60 Paund; shuma prej 200 Dhrami) **urdherohet pezullimi i ekzekutimit te këtij vendimi për të gjithë periudhën e zhvillimit të procedimit penal që po zhvillohet kundër të pandehurit N.C etj.**

ç) Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Agjensia per Administrimin e Pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara prane Ministrise se Finances Tirane, **nëpërmjet administratorit z.E.B**

Shpenzimet proceduriale i ngarkohen të dyshuarit N.C.

Kundër vendimit lejohet Ankim, brënda afatt ligjor, në Gjykatën e Apelit Për Krime të Rënda Tiranë.

U shpall në Tiranë më 15.01.2010 ora 13.30.

SEKRETARE
Suela ARAPI

GJYQTAR
Gurali BRAHIMLLARI